



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.248-2/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Rugova Husaj - kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën Blerim Krasniqi, kandidat për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokratike e Kosovës të paraqitur kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Gllogoc, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 29.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa ZL.Anr.248/2025, e datës 18.10.2025, e parashtruar nga Blerim Krasniqi, kandidat për asamble komunale Blerim Krasniqi, kandidat për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate e Kosovës paraqitur kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Gllogoc për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 18.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokratike e Kosovës me të cilën pretendon se ankesa ka të bëjë me disa probleme serioze që kanë ndodhur gjatë zgjedhjeve të fundit, përkatësisht ka pasur mungesë të votave në sistemin zgjedhor, pavarësisht se qytetarët dhe anëtarët e familjes së tij kishin votuar në mënyrë të rregullt. Disa nga qendrat e votimit me të cilat pretendon se ka pasur shkelje dhe duhet të hetohen janë këto qendra të votimit : 0317/01, 317/02, 31703 nuk janë regjistruar votat e familjarëve të mi, të cilët kanë votuar në këto qendra, Halil Bajraktari 302 – votat e familjes time mungojnë në këtë qendër; Ali Gashi 0303 – votat e një familjari mungojnë këtu; Qendra 0304 – po ashtu, votat e familjarëve të mi nuk janë regjistruar; Qendrat 311, 312, 313, 318, 325, 326, 328 – votat e familjarëve të mi mungojnë gjithashtu në këto qendra. Me tutje deklaroi se një numër i konsiderueshëm i votave janë shpallur të pavlefshme, edhe pse qytetarët e kanë ushtruar të drejtën e tyre të votës në mënyrë të rregullt. Kjo kishte ndikuar në rrezikimin e rezultateve të drejtë dhe të saktë zgjedhore.

Me këtë kërkon hetim të detajuar dhe verifikim të regjistrimit të votave në sistemin elektronik të KQZ, për të siguruar që të gjitha votat që janë hedhur, të regjistrohen në mënyrë të drejtë dhe të saktë. Kjo është e nevojshme për të garantuar integritetin e zgjedhjeve dhe për të mbrojtur të drejtën e çdo qytetari për të votuar.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, theksojnë se pretendimet e palës ankuese, Blerim Krasniqi nga subjekti politik NISMA Socialdemokrate i cili pretendon se ka pasur mungesë të votave pavarësisht se qytetarët dhe anëtarët e familjes së tij kanë votuar në mënyrë të rregullt në qendra të votimit të lartcekura në ankesë, pra në këto qendra të votimit i mungojnë votat e familjarëve. Gjithashtu pala pretendon se një numër i konsiderueshëm i votave i janë shpallur të pavlefshme edhe pse qytetarët e kanë ushtruar të drejtën e tyre të votës në mënyrë të rregullt, dhe kjo ka ndikuar në rrezikimin e rezultateve. Në ato vendvotime janë numëruar vetëm votat për Subjektet Politike, pra jo për kandidat. Formularët të cilët janë bashkangjitur janë formular indigo nga vendvotimet për subjektet politike, rrjedhimisht këto nuk kanë të bëjnë me votat e kandidatëve, sepse numërimi për vota të kandidatëve ka ndodhur në QKN dhe nga të cilët janë krijuar formularët digjital, janë printuar dhe nënshkruar nga ekipi i numërimit.

Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunal të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar me 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Tutje KQZ ka theksuar se rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP.

PZAP, pas shqyrtimit të kësaj ankese, me vendimin ZL.A.nr.248/2025 të datës 20.10.2025, ka refuzuar ankesën e Blerim Krasniqi, kandidat për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate.

Në procedurë ankimore, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin A.A.nr.97/2025 të datës 24.10.2021, ka aprovuar ankesën e Blerim Krasniqi, kandidat për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate në Komunën së Glllogocit, dhe ka anuluar vendimin e PZAP-it ZL.A.nr.248/2025 të datës 20.10.2025, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje në PZAP.

Me rastin e rivendosjes sipas ankesës së lartë përmendur të ankuesit Blerim Krasniqi, duke vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës, në aktvendimin A.A.nr.97/2025 i datës 24.10.2025, dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në këtë procedurë të rivendosjes, PZAP-i hetoi dhe mblodhi prova analizoi dhe vlerësoi të gjitha provat nga shkresat e lëndës, dhe nga gjitha shkresat dhe provat e gjetura erdhi në përfundim se:

- Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoj se pretendimet e kandidatit për Asamble Komunale nga subjekti politik i NISMA-s Blerim Krasniqi në Gillogoc, janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe as pas hetimeve të bëra nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullësi në qendra të votimit të cekura në ankesë. Kandidati në fjalë nuk ka sjell prova që dëshmojnë numrin e saktë të votave që i mungojnë dhe nuk e ka provuar me dëshmi konkrete, ndërsa provat e bashkangjitura në ankesë dhe atë deklarata Xhelil Halilaj, Sami Topalli dhe Arjeta Raci Topalli, Ardian Shala dhe Alban Shala Sami Kiqina, Ali, Selvete, Muharem, Liridonë që të gjithë me mbiemrin Francaj të njëjtat nuk i plotësojnë kushtet e një deklarate, ngase nuk janë identifikuar qendrat konkrete të votimit. Por, edhe sikur këto deklarata të jenë në rregull do të thotë të plotësojnë kushtet e deklaratës, me to nuk mund të provohet pretendimi se ata persona e kanë votuar kandidatin në fjalë pasi që votimi ka qenë i fshehtë.

Paneli ka siguruar formularët dhe nuk mund të vërtetohet ndonjë parregullsi gjatë numërimit apo mos regjistrim të votës, pasi që nuk ka mospërputhshmëri të rezultateve.

Pretendimi ankimor i ankuesit se në qendrat e votimit 0317/1, 317/02, 310//2, nuk janë regjistruar votat e familjareve të mi, të cilët kanë votuar në këto qendra, për çka ka bashkangjitur edhe prova – deklarata, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që, nuk ka ofruar prova të qarta dhe bindëse se në këto qendra të votimit kanë votuar familjarët e tij, pasi që nuk ka dhënë emrat, mbiemrat e Familjarëve për të cilat pretendon se kanë votuar për parashtruesin e ankesës, njëherit Paneli gjatë hetimit ka konstatuar se në Qendrën e Votimit 310/03, është një votë për parashtruesin e ankesës, mirëpo kjo votë nuk mund të dihet se nga cili votues është votuar.

Pretendimi ankimor i parashtruesit të ankesës se votat e Familjarëve time mungojnë në, dhe atë Halil Bajraktari 302, Ali Gashi 0303, Qendra 0304, Qendrat 311,312,313,318,325,326,328, këto pretendim janë të pa bazuara, pasi që për Qendrat 0304, 311,312,313,318,325,326,328, vetëm janë pretendime të ankuesit për pritshmëri të votave të parashtruesit të ankesës. Parashtruesi i ankesës për këto Qendra nuk ka dhënë të dhëna për emrat, mbiemrat e Familjarëve për të cilat pretendon se kanë votuar për të njëjtit. Ankuesi i cek qendrat e votimit, por nuk i specifikon vendvotimet e sakta (shem. Vendvotimi 0302/01 tej) pasi në qendër e votimit mund të ketë disa vendvotime. Prandaj paneli vlerëson se në tërësi këto pretendime ankimore janë të pa bazuara.

Kolegji ka vlerësuar edhe pretendimet për numër të madhe të votave të pa vlefshme, por këto pretendime i ka vlerësuar si të pa bazuara, ngase numërimi për kandidatët asambleist bëhet në vetëm në Qendrën Komunale të Numërimit, numërimi bëhet në mënyrë transparente ashtu siç është paraparë me nenin 15 dhe 16 dhe 17 të Rregullores Zgjedhore 16/2024 dhe Procedurës së paraparë të Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për zgjedhjet Lokale 2025, numërimi bëhet në Qendrën e Numërimit duke kaluar nëpërmes sistemit digjital, ku më këtë rast çdo fletëvotim në të dy anët shfaqet në ekran të cilën e shohin të gjithë personat e pranishëm, komisionarët, vëzhguesit e subjekteve politike dhe mediat e akredituara ku dhe mund të bëhen vërejtje lidhur me votat nëse duhet të konsiderohet e vlefshme apo jo. Në vendvotimet 0317/1, 317/02, 310//2, dhe 03, si dhe 0328/2 dhe 0328/03, paneli pas hetimit nuk ka gjetur se kishte ndonjë vërejtje apo kundërshtim ndaj cilësdo fletëvotim të vlefshëm apo të pavlefshëm, dhe ankesat e tilla kanë mundur të bëhen në PZAP në afat prej 48 orëve nga hasja në parregullsi gjatë numërimit.

Ndërsa për pretendimet për vota të pa vlefshme për vendvotimet e tjera për qendrat e votimit 302, Ali Gashi 0303, Qendra 0304, Qendrat 311,312,313,318,325,326,328, i njëjti siç u cek më lartë nuk i ka specifikuar qendrat konkrete të votimit në mënyrë që të mund të verifikohen.

Duhet cekur se lidhur me deklarata e votuesve dhe fshehtësisë së votimit, është krijuar tashmë praktika gjyqësore nga se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj AA.nr.61/2025 të datës 24.03.2025 kishte konstatuar se: *”deklaratat e votuesve të cilët pretendojnë se kanë votuar një kandidat të caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit”*.

Bazuar në të lartcekurat paneli vlerësoj se bazuar në nenin 117.3 të LZP-së përcaktohet se: *”Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*. Sipas kësaj dispozite ligjore parashtruesi i ankesës duhet të sjell dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e tij, por që me rastin e parashtrimin të ankesës nga Blerim Krasniqi, kandidat për asamble komunale e subjektit politik Nisma Socialdemokrate e Kosovës, nuk ka sjell dëshmi që vërtetohen pretendimet e tij, ndërsa pretendimet e tilla nuk kanë gjete mbështetje edhe pas hetimit dhe provave të siguruara nga PZAP, andaj pretendimi se duhet të ketë rinumërim të votave mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *”PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *”PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë”*, andaj vlerësoj se ankesa e lartë përmendur nuk është e bazuar dhe të njëjtën vendosi që ta refuzoj si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZLAnr.248-2/2025 më datën 29.10.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Rugova Husaj



Këshilla Juridike: *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.105/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mr.Sc.Muhamet Rexha, kryetar, Milena Gjeriq dhe Faton Bajrami, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së kandidatit për Asamble Komunale në Komunën e Glllogocit, Blerim Krasniqi, nga Subjekti Politik Nisma Socialdemokrate, i përfaqësuar sipas autorizimit nga “SHALA LAW OFFICE” L.L.C.me avokat Halim Shala, në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më dt.12 Tetor 2025, të paraqitur kundër Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ZL.A.nr.248-2/2025 dt.29.10.2025, në seancën e mbajtur me datë 4.11.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e parashtruar nga Blerim Krasniqi, kandidat për Asamble Komunale në Komunën e Glllogocit, nga Subjekti Politik Nisma Socialdemokrate, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL. Anr.248-2/2025 të datës 29.10.2025.

A r s y e t i m i

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa e Parashtresa (PZAP) ZL.Anr.248-2/2025/2021 të datës 29.10.2025, është vendosur të refuzohet e pabazuar ankesa ZL.Anr.248/2025



e dt.18.10.2025, e parashtruar nga Blerim Krasniqi, kandidat për Asamble Komunale në Gllogoc, nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate e Kosovës, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), për Zgjedhjet Lokale të dt.12 Tetor 2025.

Kundër Vendimit të sipër përmendur të PZAP-së, Blerim Krasniqi, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilën konteston ligjshmërinë e vendimit të PZAP-së, duke propozuar që të aprovet ankesa si e bazuar, të anulohet vendimi i PZAP-së, i sipër cekur, të urdhërohet rinumërimi i votave në Qendrat e kontestuara, me numrat e specifikuar si në ankesë, të urdhërojë PZAP-in që të kryej hetim të plotë, transparent dhe të dokumentuar për përputhshmërinë e formularëve, ekzistencën e nënshkrimeve dhe verifikimin fizik të kutive të votimit, të lejoj prezencën e tij ose të autorizuarit gjatë procesit të rinumërimit, të konstatojë se PZAP ka vendosur në kundërshtim me parimin e pavarësisë institucionale dhe mbikëqyrjes efektive ndaj KQZ-së duke cenuar besimin në procesin zgjedhor.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në përgjigje të ankesës, qëndroi në konstatimet e paraqitura në vendimin e vet, dhe propozoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të vendimit të atakuar pretendimeve ankimore dhe atyre në përgjigje në ankesë, si dhe shqyrtimit shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se PZAP-i më dt.18.10.2025, ka pranuar ankesën e kandidatit për Asamble Komunale nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate e Kosovës, me të cilën pretendon se ka pasur mungesë të votave, pavarësisht se qytetarët dhe anëtarët e familjes së tij kishin votuar në mënyrë të rregullt dhe se ka pasur shkelje në disa nga Qendrat e Votimit si nr: 0317/01, 317/02, 31703, nuk janë regjistruar votat e familjarëve të tij, të cilët kanë votuar në këto Qendra, Halil bajraktari 302, votat e familjes time mungojnë, Ali Gashi 0303 votat e një familjari mungojnë, Qendra 0304, po ashtu, Qendrat 311, 312, 313, 318,325, 326,328, votat e familjarëve të mi thekson se mungojnë. Më tej, ka theksuar se një numër i konsiderueshëm i votave janë shpallur të pavlefshme etj. Në anën tjetër, në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), kanë theksuar se pretendimet e ankuesit Blerim Krasniqi, që pretendon se ka pasur mungesë të votave, pavarësisht se qytetarët dhe anëtarët e familjes së tij kanë votuar më



mënyrë të rregullt në Qendra të Votimit, pra, në ato Qendra i mungojnë votat e familjarëve. Po ashtu thekson se një numër i votave janë shpallur të pavlefshme dhe kjo ka ndikuar në rrezikimin e rezultateve. Në ato vendvotime janë numëruar vetëm votat për Subjektet Politike, pra, jo për kandidatët. Formularët të cilët janë bashkangjitur janë formular indigo nga vendvotimet për subjektet politike, rrjedhimisht këto nuk kanë të bëjnë me votat e kandidatëve, sepse numërimi për vota të kandidatëve ka ndodhur në QKN dhe nga të cilat janë krijuar formularët digjital, janë printuar dhe nënshkruar nga ekipi i numërimit. Në procedurën e rivendosjes, PZAP-i, potencon më tej, se ka vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin A.A.nr.97/2025 dt.24.10.2025, hetoi dhe mbledhi prova, analizoi dhe vlerësoi të gjitha provat dhe shkresat e lëndës, dhe erdhi në përfundim se ankesa është e pa bazuar. Kështu, pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë, vlerësoi se pretendimet e kandidatit Blerim Krasniqi, janë të paqëndrueshme nga se pas hetimeve të bëra, nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet se ka pasur parregullsi në qendrat e votimit të cekura në ankesë. Kandidati në fjalë nuk ka arritur të sjellë prova që dëshmojnë numrin e saktë të votave që i mungojnë dhe nuk e ka provuar me dëshmi konkrete, ndërsa, deklaratat e Xhelil Halilaj, Sami Topalli etj, si në ankesë, të gjithë me mbiemrin Francaj, të njëjtat nuk i plotësojnë kushtet e një deklarate nga se nuk janë identifikuar qendrat konkrete të votimit, por edhe sikur ato të ishin në rregull, me to nuk mund të provohet pretendimi se ata persona e kanë votuar kandidatin në fjalë pasi që votimi ka qenë i fshehtë. PZAP-i , veç tjerash, ka siguruar formularët dhe nuk mund të vërtetohet ndonjë parregullsi gjatë numërimit apo mos regjistrim i votës, pasi që nuk ka mos përputhshmëri të rezultateve. Pretendimi ankimor i ankuesit se në qendrat e votimit 0317/1, 317/02, 310/2 nuk janë regjistruar votat e familjarëve të tij, që kanë votuar në këto qendra, është i pa bazuar, pasi që nuk ka ofruar prova të qarta dhe bindëse se në këto qendra të votimit kanë votuar familjarët e tij, pasi që nuk ka dhënë emrat, mbiemrat e familjarëve për të cilët pretendon se kanë votuar për parashtruesin e ankesës, njëherit PZAP gjatë hetimit ka konstatuar se në Qendrën e Votimit 310/03, është një votë për parashtruesin e ankesës, mirëpo, kjo votë nuk dihet se nga cili votues është votuar. Pretendimi ankimor i ankuesit se votat e familjarëve të tij mungojnë dhe atë Halil Bajraktari 302, Ali Gashi 0303, Qendra 0304, Qendrat 311, 312, 313, 318, 325, 326, 328, këto pretendime janë të pabazuara, pasi që Qendrat 0304, 311, 312, 313, 318, 325, 326, 328, vetëm janë pretendime të tij për pritshmëri të votave të parashtruesit të ankesës. Ankuesi cek qendrat e votimit, por nuk i specifikon vendvotimet e sakta (shembull vendvotimi 0302/01 etj), pasi që në qendër të votimit mund të ketë disa vendvotime, andaj, Paneli, vlerëson se pretendimet ankimore janë të



pabazuara. Pretendimet për numër të madh të votave të pavlefshme, po ashtu, janë vlerësuar si të pabazuara, nga se numërimi për kandidatët asambleist bëhet në Qendrën Komunale të Numërimit, numërimi bëhet në mënyrë transparente ashtu siç është paraparë me nenin 15, 16 dhe 17 të Rregullores Zgjedhore 16/2024 dhe Procedurës së paraparë të veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet lokale 2025, numërimi bëhet në Qendrën e Numërimit duke kaluar nëpërmes sistemit digjital, ku me këtë rast çdo fletëvotim në të dy anët shfaqet në ekran të cilën e shohin të gjithë personat e pranishëm, komisionarët, vëzhguesit e subjekteve politike dhe mediat e akredituara ku edhe mund të bëhen vërejtje lidhur me votat nëse duhet të konsiderohet e vlefshme apo jo. Në vendvotimet 0317/1, 317/02, 310/2 dhe 03 si dhe 0328/2 dhe 0328/03, Paneli, pas hetimit nuk ka gjetur se kishte ndonjë vërejtje apo kundërshtim ndaj cilitdo fletëvotim të vlefshëm apo të pavlefshëm dhe ankesat e tilla kanë mundur të bëhen në PZAP në afat prej 48 orëve nga hasja në parregullsi gjatë numërimit.

Prandaj, nga të lartë cekurat, PZAP-i konstatoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të veta, nuk ka ofruar prova apo dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, por vetëm thekson në mënyrë të përgjithshme se ka mungesë të votave dhe se qytetarët (e familjarët) i kanë premtuar se do ta votojnë, ndërkohë që, në kuptim të dispozitës së nenit 117 par.3 të LZP-së, përcaktohet se “ Vendorsja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, por që në rastin konkret, rezulton se, nga parashtruesi i ankesës, nuk janë argumentuar me prova dhe dëshmi pretendimet për shkeljet e theksuara nga ai, prandaj, PZAP-i në bazë të dispozitave të nenit 117, nenit 118 etj, të LZP-së, ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të tij.

Gjykata Supreme e Kosovës e pranon si të bazuar qëndrimin juridik të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, sipas të cilit ankesa e paraqitur nga këtu ankuesi Blerim Krasniqi, është e pabazuar dhe vendosja si në dispozitiv të vendimit, kur është refuzuar ankesa e parashtruesit, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen votat në Vendvotimet e sipër përmendura, për faktin se ankuesi nuk ka qenë në gjendje të dëshmojë në bazë të provave eventuale, të njëjtat, pra, edhe nuk i janë bashkangjitur shkresave e lëndës se ka pasur parregullsi në këto vendvotime dhe si rrjedhojë manipulim të votave, e që do të ishte arsye për miratimin eventual të ankesës së tij.



Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, përcaktuese për ligjshmërinë e vendimit të PZAP, është fakti se ankuesi ka parashtruar pretendime të paprovuara për parregullsi a manipulim të votave. Pretendimet për dëshmi në formë të deklarimeve të ankuesit “ se më kanë premtuar qytetarët (dhe familjarët) që do të më votojnë ...), nuk përbëjnë provë të besueshme, dhe se çdo pretendim për manipulim të votave, duhet të provohet katërçipërisht dhe në masë të besueshme si dhe njëkohësisht duhet të ketë pretendime të qarta se si rezultat i këtyre manipulimeve është ndikuar në rezultatin përfundimtar, me të cilën ankuesit iu ka cenuar ndonjë e drejtë, që do të thotë se për shkak të këtyre manipulimeve ankuesit iu ka pamundësuar zgjedhja për anëtarë të Asamblesë Komunale përkatëse, mirëpo, apriori, nuk konsiderohet se i është cenuar interesi i tij, deri sa nuk është ndikuar drejtpërdrejt në zgjedhjen e tij për pozitën për të cilën ka konkurruar, andaj pretendimet në ankesë janë pa ndikim për të vendosur ndryshe. Ndaj, nga arsyet e sipër përmendura, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se me pretendimet e tilla ankimore, paraqitësi i ankesës, nuk ka arritur që të vë në dyshim zbatimin e dispozitave përkatëse ligjore dhe gjendjen faktike të vërtetuar si më sipër, nga ana e organit vendimi i të cilit kontestohet, i cili, përkitazi me rastin konkret, ka marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Në këtë kontekst Gjykata Supreme e pranon në tërësi arsyetimin e dhënë nga PZAP, lidhur me mungesën e provave për të bazuar pretendimet e parashtruara dhe lidhur me referencat ligjore për bazën e refuzimit të ankesës të parashtruar nga ankuesi ndaj vendimit të sipër cekur të PZAP-së.

Për arsyet e paraqitura më lart, e në pajtim me nenin 118 pika 4 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.105/2025, datë 4.11.2025

Kryetar i kolegjit, gjyqtari
Mr.Sc.Muhamet Rexha



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Funktori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVITICA ZA LJICNO DOSTAVLANJE

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-105/2025

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dëshitë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesë apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit mëdhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërsesë, fqut, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrace susedu lieu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (približno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201__ në ora _____
Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijma _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesit, duke shkruar shkaktun pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljaoc.

Fm 12/08

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTG-726/14

04.11.2025

Numri i shtojcave: _____
broj priloga _____

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdjujmo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

APRIL 05.11.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismo primilo u zancam)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca